



BASHKIA SELENICE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SELENICË
DREJTORIA E BURIMEVE NJEREZORE, NDIHMES LIGJORE DHE MARREDHENIEVE ME
PUBLIKUN

Nr **462** Prot.

Selenicë, më **17.02**.2026

**SHPALLJE PËR NËPUNËS CIVIL,
LËVIZJE PARALELE DHE PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL**

Specialist

Kategoria e pagës IV-3

Lloji i diplomës “ Shkenca Shoqërore” niveli minimal i diplomës “Bachelor

Në zbatim të nenit 26 të Ligjit Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe të Kreut II dhe III, të Vendimit Nr. 242, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave, Bashkia Selenicë procedurat e lëvizjes paralele dhe pranim në shërbim civil për pozicionin:

Specialist “Informacioni” – Drejtoria e Burimeve Njerezore Ndihtmes ligjore dhe marredhenieve me Publikun“

Plotësimi i pozicionit më sipër bëhet nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele dhe pranim në shërbim civil.

Për të dyja Procedurat (lëvizje paralele dhe pranim në shërbim civil)

aplikohet në të njëjtën kohë!

Afati për dorëzimin e Dokumenteve:

për lëvizjen paralele do të jetë 04.03.2026

për pranim në shërbimin civil 10.03.2026

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:

Pozicioni kontribuon në forcimin e imazhit institucional të Bashkisë Selenicë dhe në rritjen e besimit të publikut përmes informimit të saktë dhe shërbimit cilësor

Është punonjës civil dhe është në varësi të Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore

- Siguron komunikimin e vazhdueshëm me publikun përmes kanaleve zyrtare të Bashkisë (faqja web, rrjete sociale, njoftime publike, media), në bashkëpunim me strukturat përkatëse.
- Përgatit njoftime, komunikata për shtyp, përshkrime aktiviteteve dhe materiale informuese mbi veprimtarinë e Bashkisë.
- Administron kërkesat, ankesat dhe pyetjet e qytetarëve që vijnë përmes kanaleve të komunikimit, duke i regjistruar dhe përcjellë për trajtim pranë strukturave përkatëse dhe duke ndjekur përgjigjen brenda afateve ligjore.
- Kujdeset për respektimin e etikës së komunikimit, gjuhës institucionale dhe standardeve të shërbimit ndaj qytetarëve.
- Bashkëpunon me njësitë organizative të Bashkisë për koordinimin e mesazheve publike dhe harmonizimin e informacionit që publikohet.
- Kontribuon në hartimin dhe zbatimin e planeve të komunikimit dhe strategjive për përmirësimin e marrëdhënieve me publikun.
- Zbaton aktet ligjore dhe nënligjore në fushën e administratës publike, të drejtës së informimit, mbrojtjes së të dhënave personale dhe etikës së nëpunësit civil.

Kryen çdo detyrë tjetër të ngarkuar nga eprori, në përputhje me funksionin dhe legjislacionin në fuqi

I-LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- a- Të jenë nëpunës civil të konfirmuar, brenda së njëjtës kategori (kategoria IV-3);
- b- Të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
- c- Të kenë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”;

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- Të zotërojnë minimalisht diplomë të nivelit “Bachelor”, në Shkenca shoqërore.
- Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi.
- Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grupë..
- Të kenë njohuri të mira kompjuterike.

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:
<http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-Dokumente/219-udhezime-Dokumente>
- b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e- Vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
- f- Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore;
- g- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- i- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 04.03.2026.

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën 05.03.2026, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Bashkia Selenice ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit ku ndodhet

pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni, nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

1.4

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

- a) Njohuritë mbi Ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij.
- b) Njohuritë mbi Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”.
- c) Njohuritë mbi Ligjin nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.
- d) Njohuritë mbi Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë.
- e) Njohuritë mbi Ligjin nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”.
- f) Njohuritë mbi Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.
- g) Njohuritë mbi Ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”, në pjesën që lidhet me komunikimin me publikun dhe shërbimet administrative.
- h) Njohuritë mbi aktet nënligjore dhe rregulloret e brendshme të Bashkisë Pukë për protokollin, komunikimin institucional dhe marrëdhëniet me publikun.
- i) Njohuritë bazë mbi standardet e komunikimit institucional, protokollin shtetëror dhe marrëdhëniet me median

1.5

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me Dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe certifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë në rastet kur procesi i certifikimit nuk është kryer. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë.

1.6**DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Bashkia Selenicë do të shpallë fituesin në Faqen Zyrtare të Bashkisë, Shërbimin Kombëtar të Punësimit dhe në stendën e informimit të publikut. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike .

2- PRANIM NE SHERBIM CIVIL

Vetëm në rast se nga pozicionet e renditura në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicione vakante, këto pozicione janë të vlefshme për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimi në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët që plotësojnë kërkesat e përgjithshme në përputhje me nenin 21, të Ligjit Nr. 152/2013, “Për nepunesit civil”, i ndryshuar.

2.1**KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL DHE KRITERET E VEÇANTA**

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimi në shërbimin civil janë:

- a) Të jetë shtetas shqiptar;
- b) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d) Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e) Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- f) Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas Ligjit Nr. 152/2013, “Për nepunësin civil”, i ndryshuar.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- Të zotërojë minimalisht diplomë të nivelit “Bachelor”, në Shkenca shoqërore.

- Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi.
- Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grupë..
- Të kenë njohuri të mira kompjuterike

2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë Dokumentet si më poshtë:

- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:
<http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-Dokumente/219-udhezime-Dokumente>
- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- Vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
- Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore;
- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 10.03.2026.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimit në shërbimin civil , do të informohen për fazat e mëtejshme të kësaj procedure:

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak,
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi;
- mënyrën e vlerësimit të kandidatëve.

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën 11.03.2026, njësi e menaxhimit të burimeve njerëzore të Bashkisë Selenicë ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i

Punësimit” listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni, nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

2.4

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a) Njohuritë mbi Ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij.
- b) Njohuritë mbi Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”.
- c) Njohuritë mbi Ligjin nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.
- d) Njohuritë mbi Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë.
- e) Njohuritë mbi Ligjin nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”.
- f) Njohuritë mbi Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.
- g) Njohuritë mbi Ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”, në pjesën që lidhet me komunikimin me publikun dhe shërbimet administrative.
- h) Njohuritë mbi aktet nënligjore dhe rregulloret e brendshme të Bashkisë Pukë për protokollin, komunikimin institucional dhe marrëdhëniet me publikun.
- i) Njohuritë bazë mbi standardet e komunikimit institucional, protokollin shtetëror dhe marrëdhëniet me median.

2.5

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a) Vlerësimin me shkrim, deri në 60 pikë;
- b) Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 25 pikë;
 Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 15 pikë

2.6**DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Bashkise Selenicë do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për rezultatet.

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE

Joda Ngucaj

